



TIPOLOGJI TË PASTRIMIT TË PARAVE ME ANË TË ASETETEVE VIRTUALE

Shkurtime

AV	– Asete Virtuale
NJIF	– Njësi e Inteligjencës Financiare
OSHAV	– Ofruesit e Shërbimeve të Aseteve Virtuale
PPP/FT	– Parandalimi i Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit
PP	– Pastrimi i Parave
RAD	– Raport i Aktivitetit të Dyshimtë
TF	– Financimi i Terrorizmit
VDK	– Vigjilenca e duhur ndaj klientit

HYRJE

Asetet virtuale dhe shërbimet e lidhura me to, kanë një potencial të konsiderueshëm për sa i përket inovacionit dhe efikasitetit në fushën financiare, por disa nga veçoritë e tyre krijojnë gjithashtu mundësi të reja, për persona të përfshirë në fushën e PP/FT dhe financimit të terrorizmit. Aftësia për të kryer transaksione në nivel ndërkombëtar nëpërmjet asetëve virtuale, ju mundëson grupeve kriminale të ruajnë pasuritë e tyre në formë elektronike, shpesh dhe jashtë vëndit duke kamufluar origjinën apo destinacionin e fondeve nëpërmjet anonimitetit.

Këto veçori çënojnë aftësinë e subjekteve raportuese, për të identifikuar aktivitete të dyshimta, që përbën një prej faktorëve thelbësor, në zbulimin dhe hetimin e veprave kriminale nga autoritetet kompetente.

Ky raport është rezultat i një kontributi të gjerë nga anëtarët e FATF dhe synon të sigurojë një mjet praktik si për sektorin publik ashtu edhe për atë privat në identifikimin, zbulimin dhe në parandalimin e veprimtarive kriminale, të PP/FT nëpërmjet përdorimit të AV.

Nëpërmjet publikimit të këtyre tipologjive ndërkombëtare, Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave, synon të rrisë më tej kapacitetet parandaluese të subjekteve të ligjit si dhe të orientojë punën e tyre drejt zhvillimeve teknologjike, të cilat paraqesin një rrezik të shtuar në aktivitetin e tyre.

Transferta të shumëfishta të menjëhershme të një sasive të madhe të AV në një OSHAV jashtë vëndit

Një OSHAV vëndas, paraqiti një RAD mbi bazën e dyshimeve të krijuara në lidhje me blerjen e shumave të mëdha të AV nga individë të ndryshëm dhe transferimet e menjëhershme të tyre tek një OSHAV, në një vënd të huaj. Në disa raste, individët kishin të njëjtën adresë banimi dhe qasja në shumicën e AV sigurohej nëpërmjet të njëjtës adresë IP, që përbënte një tregues potencial të përdorimit të individëve si “transportues”¹, nga profesionistë të përfshirë në pastrimin e të ardhurave të jashtëligjshme.

Përveç kësaj, shtresëzimi² i shumëfishtë i fondeve ishte realizuar përpara blerjes së AV nga “transportuesit”. Për të maskuar origjinën e fondeve, paratë fillimisht depozitoheshin në llogari në IF të ndryshme në gjithë vëndin dhe më pas këto fonde u transferuan në llogari, të mbajtura në emër të subjekteve të ndryshme, të regjistruara në vënd. Nëpërmjet këtyre llogarive kryheshin gjithashtu, pagesa elektronike në shuma të vogla. Pas kësaj, fondet u transferuan në një grup tjetër llogarish, përpara se të përfundonin në llogaritë e “transportuesve”, të mbajtura në OSHAV vëndase. AV u blenë menjëherë dhe u transferuan te OSHAV e huaja.

Në këtë rast u përfshinë rreth 150 individë, të cilët mundësuan transferimin e një totali prej 108 352 900 USD (ose 11,960 Bitcoin) në llogari të shumta AV të mbajtura nga dy OSHAV jashtë vëndit.

Burimi: Afrika e Jugut

1 Në fushën e PP/FT një transportuese (në anglisht a money mule ose smurfer), është një person i cili transferon për llogari të tjerëve (p.sh personalisht, shërbimit të postës ose me anë të kompanive të transferateve) fonde të siguruara nga aktivitete të jashtëligjshme. Për këtë shërbim ai paguhet nga një pjesë e fondeve të transferuara.

2 Fazat e PP/FT janë vendosja, shtresëzimi dhe integrimi i fondeve apo pasurive të jashtëligjshme

AV të shumëfishta dhe transferime të shumta të OSHAV të huaja

Një kompani vëndase e përfshirë në aktivitetin e shkëmbimit të AV, raportoi se afërsisht 400 million KRW³ (301 170 EUR), ishin vjedhur nga viktimat të mashtrimeve dhe së fundmi ishin shkëmbyer në AV, një teknikë e njohur që përdoret në fazën e shtresëzimit të PP.

Raportimi u bazua në faktin se ishin kryer transfertat të shumta me vlerë të lartë, në një portofol të vetëm të një OSHAV të huaj. Fondet e vjedhura, fillimisht u shkëmbyen në tre lloje të ndryshme të AV dhe pastaj u depozituan në portofolin AV të të dyshuarit, që administrohej në një OSHAV vëndas. I dyshuari më pas u përpoq të fshihte burimin e fondeve, nëpërmjet 55 transfertave të kryera përmes 48 llogarive të ndryshme të mbajtura në OSHAV vëndase dhe më pas në një portofol tjetër AV jashtë vendit.

Burimi: Korea e Jugut

Depozita fillestare të cilat nuk përputhen me profilin e klientit.

Bazuar në një sërë treguesish të dyshimtë, të cilë paraqiten në vijim një bankë, dërgoi në NJIF një RAD, që më pas çoi në një hetim për PP:

- transaksione që nuk përputheshin me profilin e mbajtësit të llogarisë. Në dy ditët e para pas hapjes së një llogarie personale për një klient të ri, u kryen një sërë depozitimesh në shuma të larta nga persona të ndryshëm juridikë;
- modelet e transaksioneve. Fondet e depozituara u transferuan brenda një dite në llogaritë e disa OSHAV, për blerjen e AV (*Bitcoin*);
- profili i klientit. Njëri nga porositësit e AV, ishte i njohur për bankën si subjekt i përfshirë në një rast mashtrimi. Banka ju ofroi autoriteteve adresat IP, të përdorura për shërbimet në internet.

³ Monedha e Koresë së Jugut.

Bazuar në hetimin e mëtejshëm rezultoi, se mbajtësi i llogarisë personale luante rolin e një “transportuesi”, i cili ishte rekrutuar nga kriminelët nëpërmjet një platforme të mediave sociale, për të ndihmuar në marrjen e pagesave të pretenduara, për mallrat e shitura në internet.

Sidoqoftë, të dhënat e transaksioneve tregonin qartë që fondet ishin depozituar nga kompani të tjera, të cilat kishin qënë viktime të mashtrimeve dhe nuk kishin asnjë lidhje me pagesat për mallrat.

Fondet e depozituara u transferuan menjëherë (përmes disa pagesave) nga llogaria personale në një llogari tjetër, të mbajtur nga një shoqëri aksionare në Republikën Çeke dhe u shkëmbyen në AV (*Bitcoin*) të mbajtur në disa OSHAV lokale. Më pas AV, u tërhoqën menjëherë nga llogaria.

Përveç raportimit të RAD, banka gjithashtu pezulloi transfertat e dyshimta, të cilat mundësuan dhe konfiskimin e fondeve.

OSHAV lokal gjithashtu vërejti parregullsi në fondet e transferuara dhe ofroi informacion të dobishëm për hetimin, i cili përfshinte:

- rrethanat në të cilat u blenë AV;
- transaksioni dhe informacione të tjera VDK siç janë adresa e portofolit, kopja e dokumentit të identifikimit të përdorur për blerjen dhe emri i blerësit të pretenduar.

Burimi: Republika Çeke

Transferimet e kryera në një kohë të përsëritur

Një IF vëndas, i përfshirë në administrimin e letrave me vlerë paraqiti një RAD në lidhje me pagesat e paautorizuara midis llogarive të tyre të AV dhe një shtetasi të huaj. Shoqëria e raportoi aktivitetin e dyshimtë, bazuar në faktin se shtetasi i huaj kërkoi të bënte transferta në vlerë prej 4.8 milion USD (në dy transaksione në të njëjtën ditë, brënda pak minutave nga njëri tjetri) dhe ditën në vijim i paraqiti IF një kërkesë për hapjen e një llogarie për tregëtimin e letrave me vlerë. Portofoli (OSHAV) i klientit nuk administrohej në Ishujt Kajman.

Raportimi i RAD, mundësoi një shkëmbim të suksesshëm të informacionit me NjIF të huaja dhe kthimin e shumicës së fondeve tek pala e dëmtuar, pasi një nga OSHA që vepronte në një nga vëndet e përfshira në transaksione, kishte qenë në gjendje të ngrinte llogarinë e të dyshuarit.

Burimi: Ishujt Kajman

Përdorimi i adresës IP të lidhur me tregun Alpha Bay

AlphaBay tregu më i madh kriminal (i mbyllur nga autoritetet në 2017) u përdor gjatë një periudhe dy-vjeçare nga qindra mijëra njerëz për të blerë dhe shitur lëndë narkotike, dokumente identifikimi të vjedhura apo të falsifikuara, pajisje dhe mallra të falsifikuara, viruse ose mjete të piraterisë kompjuterike, armë zjarri dhe kimikate toksike.

Faqja vepronte si një shërbim i fshehur në internet për të kamufluar vendndodhjet e serverave si dhe identitetet e administratorëve, ndërmjetësuesve dhe përdoruesve të saj. Shitësit në *AlphaBay*, përdornin lloje të ndryshme të AV dhe tregu kishte afërsisht 200,000 përdorues, 40,000 shitës dhe 250,000 listime duke bërë të mundur kryerjen e transaksioneve me vlerë prej 1 miliard USD në transaksionet e AV, mes viteve 2015 - 2017.

Në korrik të 2017, qeveria e SH.B.A., me ndihmën e partnerëve ndërkombëtar, pezulloi serverat e *AlphaBay*, arrestoi administratorin dhe në përputhje me një urdhër të prokurorisë së

Kalifornisë, konfiskoi pasuritë fizike dhe virtuale të tregut dhe ato që përfaqësonin të ardhurat e jashtëligjshme të kësaj ndërmarrje kriminale. Agjentët federalë siguruan urdhrat e kontrollit, pasi gjurmuan transaksionet me origjinë nga AlphaBay në llogari të tjera AV dhe identifikuan llogaritë bankare apo pasuritë e tjera të luajtshme, të kontrolluara nga administratori i pretenduar.

Burimi: SHBA

Përdorimi i mekanizmave të përzierjes dhe kombiminimi në tregun Helix

Një OSHAV me bazë në tregun ilegal *Helix*, siguronte një shërbim që ndihmonte klientët të fshihnin burimin ose pronarët e AV, kundrejt pagesës së një tarife për një periudhë tre-vjeçare. Dyshohet se *Helix* transferoi mbi 350,000 Bitcoin, me një vlerë prej mbi 300 milion USD. Operatori e reklamonte shërbimin si një mënyrë për të fshehur transaksionet nga kontrolli i agjencive të zbatimit të ligjit. Në shkurt të vitit 2020, u ngritën akuzat penale kundër një individi që ushtronte aktivitetin në *Helix*, për përfshirje në përfshirë për PP dhe drejtimin e një aktiviteti të palicencuar për transferimin e parave.

Helix, kishte bashkëpunuar me tregun *AlphaBay* deri në mbylljen e këtij të fundit në 2017.

Burimi: SHBA

Përdorimi i portofolit të decentralizuar

Ky rast demonstroi mënyrën e se si kriminelët përdorin një portofol të decentralizuar, për të fshehur burimin e fondeve të jashtëligjshme, të siguruara nga aktiviteti i lëndëve narkotike. Në këto raste, kriminelët kryenin shitje të sasive të konsiderueshme të drogës në internet dhe përveç pagesave në monedhën zyrtare pranonin dhe pagesa në forma të tjera të AV (p.sh *Bitcoin*, *EX-codes*, *EXMO-cheques*).

Fondet e jashtëligjshme, të marra në monedhën zyrtare këmbeshin në AV me ndihmën e një llogarie anonime në një platformën tregëtare online (*Blockchain*). Fonde të tilla, në formën e AV, më pas këmbeshin në monedhën zyrtare, përpara se të transferoheshin përsëri te llogaritë e kartave bankare të kriminelëve. Fondet e jashtëligjshme të përfituara nga AV, fillimisht transferoheshin në portofolin e decentralizuar (*Bitcoin*) të zotëruar nga kriminelet e përfshirë në proces, përpara se të transferoheshin më tej në një portofole të tjera (*Bitcoin*) në disa platforma këmbimi. Këto transaksione, e vështirësonin procesin e ndjekjes dhe gjurmimit të fondeve.

Burimi: Federata Ruse

Klientë që refuzojnë të paraqesin burim informacioni të fondeve

Një IF (bankë) paraqiti një RAD, në lidhje me një llogari të një shoqërie vëndase që zotëronte fonde të siguruara nga shitja e kuponave, të cilat mund të tregëtoheshin me një produkt të caktuar (në këtë rast bioplastikë). Fondet ishin depozituar në llogari, nga individë dhe persona juridik, disa prej të cilave ishin fillimisht në formën e AV. Megjithë kërkesat e bankës, përfaqësuesit e zotëruesit të llogarive bankare, nuk paraqitën asnjë informacion mbi burimin e fondeve. Nga analizat vijuese të ndërmarra nga autoritetet rezultoi që fondet e dërguara nga kompania shfaqnin lidhje me subjekte të afërta me krimin e organizuar dhe me fonde të përfituara nga një aktivitet mashtrimi.

Burimi: Italia.

Profili i klientit nuk përputhet me tregtimin e rregullt të vlerave të larta të AV

Një ofrues i shërbimeve të AV (këmbyesi) dhe një IF (në fushën e pagesave) raportuan një RAD në lidhje me tregëtimin në vlera të larta të AV, që filloi që me hapjen e një llogarie të një këmbyesi. Zotëruesi i llogarisë, kishte kryer më parë disa transaksione të shit-blerjes së AV për një vlerë mbi 180 000 Euro, e cila nuk përputhej me profilin e zotëruesit të llogarisë (p.sh të dhënat për profesionin dhe pagën e tij).

Nga analizimi i informacionit rezultoi se AV u përdorën më pas për (i) transaksione në tregun e zi; (ii) bastet online; (iii) transaksione me OSHAV, me mangësi në PPP/FT ose që kishin qenë subjekt i hetimeve të mëparshme për PP, për shuma në miliona dollar që lidheshin me operacione në platforma të shkëmbimit të AV dhe “kombinim” të tyre. Zotëruesi i llogarisë, kishte përdorur gjithashtu një sërë instrumentesh (p.sh transferta parash, shërbimet bankare në formë elektronike dhe karta me parapagim) për të kryer pagesa të rregullta.

Zotëruesit të llogarisë fondet i dërgoheshin nëpërmjet kompanive të transferimit të parave dhe sistemit bankar, nga një rrjet individësh që blinin AV (*Bitcoin*) me para në dorë dhe që ndodheshin në vënde të ndryshme në Azi dhe Europë. Ai gjithashtu përfitonte fonde në kartat e tij me parapagim nga subjekte në Afrikë dhe Lindjen e Mesme, të cilët nga ana e tyre grumbullonin fonde nga bashkëkombas që jetonin në Itali dhe vënde të tjera.

Këto fonde më pas përdorreshin për transferta ndërkombëtare ose baste elektronike dhe tërhiqeshin me para në dorë nga bankomatet në Itali.

Burimi: Italia.

Mashtrimi i viktimave të kthyer në “transportues”

Në disa mashtrime në fushën e investimeve, shtetas të huaj kontaktonin (nëpërmjet telefonit, mesazheve elektronike apo rrjeteve sociale) kryesisht persona të moshuar duke ju ofruar atyre mundësi investimi në AV (*Bitcoin* apo asete të tjera) duke i joshur me përfitime të mëdha për shkak të popullaritetit dhe rritjes së çmimit të tyre. Për investimin fillestar, kërkoheshin shuma relativisht të ulëta (në shumë raste jo më shumë se 250 Euro) dhe fondet që merreshin nga llogaria bankare e viktimave, përfundonin në duart e kriminelëve (nëpërmjet kartave të kreditit ose nëpërmjet mjeteve të tjera me shërbime pagese të ndryshme).

Një mënyrë alternative që ju ofrohej viktimave për këtë lloj investimi, ishte të shkëmbenin monedhën zyrtare në *Bitcoin* duke përdorur bankomate të AV dhe më pas fondet t’i dërgonin në një adresë të specifikuar nga kriminelët.

Personat që binin pre e këtyre mashtrimeve nuk kishin njohuri dhe nuk e kuptonin teknologjinë e AV apo se në çfarë po investonin në të vërtetë. Atyre gjithashtu ju kërkohet të instalonin një program në pajisjen e tyre elektronike, i cili komandohej nga larg me pretekstin për t'i ndihmuar të transferonin fondet në mënyrë korrekte, në llogarinë e saktë. Ky veprim manipulonte mjetet elektronike të viktimave kështu që kriminelët mund të kryenin transferta parash të pa autorizuara dhe pa dijeninë e personave të përfshirë që më vonë vërenin mungesën e parave në llogari. Në disa raste, kriminelët gjithashtu sajnin lajme duke pretenduar që njerëz të njohur, të botës së biznesit apo persona mediatik reklamonin AV, në mënyrë që të krijonin besimin e nevojshëm për ligjshmërinë e këtyre “investimeve”.

Burimi: Finlanda

Përdorimi i kompanive guackë.

Në muajin Maj të vitit 2019, Institucionet e rendit në SHBA, në zbatim të një urdhëri të gjykatës sekuestruan një faqe rrjeti të quajtur, DëepDotWeb (DDW). Pronarët e pretenduar dhe operatorët e DDW ishin të akuzuar për PP, të shumave në miliona USD të pagesave të jashtëligjshme që merrnin për promovimin që i bënin tregut ilegal në faqen e tyre të internetit. Pronarët dhe operatorët e DDW merrnin pagesa, që përfaqësonin komisionet nga të ardhurat e përfituara nga shitja e mallrave të jashtëligjshme, (p.sh. fentanoli dhe heroinë), të kryera përmes referimit të individëve në tregun ilegal.

Pagesat kryheshin me AV, në portofolin Bitcoin të kontrolluar nga DDW. Për të fshehur dhe kamufluar natyrën dhe burimin e të ardhurave të jashtëligjshme, në vlerën totale prej 15 milion USD, pronarët dhe operatorët transferonin pagesat nga portofoli *Bitcoin* i DDW në portofole të tjera Bitcoin, apo dhe në llogaritë bankare në emër të kompanive guackë. Të pandehurit përdorën këto kompani guackë, për të transferuar të ardhurat e jashtëligjshme dhe për të realizuar aktivitete të tjera të DDW. Gjatë një periudhe 5 vjeçare, faqja DDW përfitoi nga tregu ilegal pagesa në 8155 *Bitcoin*, me vlerë afërsisht 8 milion USD. AV (Bitcoin) u transferuan në

portofolin *Bitcoin* të DDW, në një seri prej më shumë se 40 000 depozitimesh dhe më pas u tërhoqën në vënde të ndryshme, nëpërmjet 2 700 transaksionesh. Vlera e Bitcoin në kohën e trërheqjes nga portofoli i DDW, vlerësohej përafërsisht në 15 milion USD.

Burimi: Shtetet e Bashkuara

Përdorimi i këmbyesve të ndryshëm të AV, dokumente identifikimi fallco dhe kartave me parapagim

Të pandehurit në këtë çështje vepronin si pjesë e një skeme të PP, që lidhej me kriminel kibernetik, të cilët ndërhyenin (piratonin) këmbyes të AV duke përvetësuar asete me vlerë 250 milion USD. Të pandehurit pastruan AV me vlerë 91 milion USD, krahas rreth 9.5 milion USD që ishin siguruar nga vjedhje të tjera kibernetike.

AV e vjedhura, më pas u qarkulluan përmes qindra transaksionesh të automatizuara dhe këmbimesh të shumëfishta. Të pandehurit, në disa raste përdorën fotografi dhe dokumente identifikimi fallco, për të anashkaluar procedurat “Njihe Klientin Tënd” në transaksionet e këmbimit të AV. Rreth 35 milion USD të fondeve të jashtëligjshme, u transferuan në llogari bankare jashtë vëndit dhe u përdorën për blerjen e kartave me parapagim, të cilat mund të këmbeshin me AV.

Të pandehurit përdornin llogari individuale apo llogari të lidhura me njëra tjetrën, më të cilat siguronin shërbimet të AV të tilla si konvertimi në monedha zyrtare të një vendi, apo transferimi tek klientët kundrejt një pagese. Të pandehurit kryenin një aktivitet biznesi në SHBA, për të cilin sipas ligjit duhet të ishin rregjistruar në autoritetin përkatës (FinCEN).

Burimi: Shtetet e Bashkuara

Tregues të Bitcoin në aktivitet të palicensuar të transfertave të parave

Në prill të vitit 2019, një person u dënua me dy vjet burg për kryerjen e aktivitetit të palicensuar të transferimit të parave pas shitjes së AV (Bitcoin) në shumën prej qindra mijëra USD, tek më shumë se njëmijë klientë në SHBA. Të pandehurit gjithashtu u urdhërua t'i konfiskohej shuma prej 823 357 USD, e siguruar nga të ardhurat e këtij aktiviteti.

I pandehuri reklamonte shërbimet e tij në faqen e internetit për përdorues të AV, duke i takuar dhe personalisht klientët, të cilët e paguanin me para në dorë në këmbim të AV. Një pjesë e klientëve paguanin nëpërmjet bankomateve në gjithë vëndin ose nëpërmjet shërbimeve të transfertave të parave. Për shërbimet e tij, i pandehuri përfitonte 5% shpërblim mbi kursin normal të këmbimit. Ai në fillim blinte *Bitcoin* nëpërmjet një operatori në SHBA. Sapo aktiviteti i tij ngjallte dyshim dhe llogaria e tij mbyllej, ai kryente këmbime me një operator në Azi, tek i cili nëpërmjet qindra transaksioneve bleu rreth 3.29 milion USD në *Bitcoin*, brënda një periudhe që shtrihej nga marsi 2015 deri në prill 2017. I pandehuri gjithashtu pranoi që kishte këmbyer më një tregëtar të metaleve të çmuara, fondet që mbaheshin në një vënd kufitar të SHBA. Gjatë viteve 2016 - 2018, ai së bashku me persona të tjerë importuan në SHBA deri në 1 milion USD, në shuma poshtë pragut të detyrimit për raportim prej 10 000 USD.

Burimi: Shtetet e Bashkuara.

TREGUES TË PËRDORIMIT TË AV DHE OSHAV PËR PASTRIM TË PRODUKTEVE TË VEPRAVE PENALE.

Treguesit e përfshirë në këtë raport lidhen me disa nga specifikat, karakteristikat dhe dobësitë që shoqërojnë AV. Ata nuk janë shterues dhe përbëjnë disa nga elementët e shumtë që kontribuojnë në kontekstin e pergjithshëm të rrezikut të mundshëm të PP ose FT. Në këtë kuadër është e rëndësishme që institucionet shtetërore dhe subjektet private të mos i shqyrtojnë ato në mënyrë të veçuar por t'i kombinojnë dhe me të dhëna të tjera që disponojnë në kuadrin e veprimtarisë së tyre.

- Transaksionet që përfshijnë përdorimin e shumë AV ose llogari të shumëfishta, pa një shpjegim logjik nga ana e klientit.

- Kryerja e transfertave të shpeshta në një periudhë të caktuar kohore (p.sh. një ditë, një javë, apo muaj të caktuar) në të njëjtën llogari AV.
 - nga më shumë se një person;
 - nga e njëjta adresë IP, nga një ose më shumë persona;
 - në shuma të konsiderueshme.
- Transaksionet hyrëse nga shumë portofole të AV (pa lidhje të qartë mes tyre) në shuma relativisht të vogla (akumulimi i fondeve), të cilat shoqërohen me transferim në një portofol tjetër ose shkëmbim në monedhat legale.
- Këmbimi i AV me monedhën legale nganjëherë dhe me humbje të mundshme (p.sh. kur ka luhatje të vlerës, ose pavarësisht nga komisionet tejet të larta krahasuar me standardet e industrisë, veçanërisht kur transaksionet nuk kanë ndonjë shpjegim logjik).
- Këmbimi i një shume të konsiderueshme (në monedhën legale) në AV, ose një lloji AV në llojet e tjera, pa ndonjë shpjegim logjik të biznesit.
- Transaksionet nga një klient që përfshijnë më shumë se një lloj AV, pavarësisht komisioneve shtesë të transaksioneve dhe veçanërisht ato AV që ofrojnë mundësi më të larta anonimiti.
- Transferimi i një AV të një platforme publike dhe transparente (p.sh. Bitcoin) drejt një burse të centralizuar, për ta këmbyer në AV që ofrojnë anonimat.
- Klientët që veprojnë si një OSHAV të palicencuar në platformat direkte (*peer-to-peer* P2P), në bursat që ofrohen në faqet e internetit, veçanërisht kur ekzistojnë të dhëna se ata kryejnë volume të konsiderueshme të transfertave të AV për të cilat aplikojnë komisione më të larta se ato në treg. Përdorimi i llogarive bankare për të mundësuar këto transaksione.
- Aktiviteti anormal i transaksioneve (p.sh. niveli apo vëllimi) i AV të arkëtuara apo shkëmbime nga portofolet e lidhura me platformën P2P pa asnjë shpjegim logjik.
- AV të transferuara te ose nga portofolet që ngjajnë me modele të mëparshme të aktivitetit të shoqëruara me përdorimin e OSHAV që ofojnë shërbime të kombinimit apo të platformave P2P.
- Krijimi i llogarive të ndara dhe në emra të ndryshëm, për të shmangur kufizimet mbi kufijtë e tregtimit ose tërheqjes të vendosura nga OSHAV.
- Transaksionet të nisura nga adresa (IP) jo të besueshme, adresa nga vende ndaj të cilëve aplikohen sanksione ndërkombëtare ose adresa të identifikuar si të dyshimta.
- Përpjekja për të hapur shpesh një llogari brenda të njëjtit OSHAV nga e njëjta Adresë IP.
- Përfaqësuesit e korporatave, regjistrimet e *domain* të tyre në Internet, i realizojnë në një vënd të ndryshëm nga vëndi i themelimit;
- Informacion i mangët ose i pamjaftueshëm për NJKT, ose një klient refuzon kërkesat për dokumentet ose pyetjet e NJKT, në lidhje me burimin e fondeve.
- Dërguesit apo marrësit nuk kanë njohuri ose japin informacion të pasaktë në lidhje me transaksionin, burimin e fondeve, ose marrëdhëniet me palën tjetër.
- Klienti ofron të dhëna për identifikimin ose përdoruesin që përdoret dhe nga llogari të tjera (p.sh. adresë IP jo standarde).
- Mospërputhjet mes adresave IP të lidhura me profilin e klientit dhe adresave IP, nga të cilat kryhen transaksionet.
- Adresa AV e një klienti, shfaqet në forume publike të lidhura me aktivitete të jashtëligjshme.

- Për klientin ekzistojnë të dhëna publike për shkak të lidhjeve të mëparshme kriminale në fushën e AV.
- Dërguesi i transfertë nuk duket të jetë i njohur me teknologjinë AV ose me instrumentet e portofolëve virtual. Persona të tillë mund të jenë “transportues” të rekrutuar nga profesionistë të pastrimit të parave, ose viktimë të mashtrimit të shndërruar në “transportues”, të cilët janë të mashtruar në transferimin e të ardhurave të jashtëligjshme, pa dijeni për origjinën e tyre.
- Një klient dukshëm më i vjetër se moshë mesatare e përdoruesve të platformës, hap një llogari dhe kryen një numër të madh transaksionesh me AV. Persona të tillë mund të jenë “transportues” ose viktimë e mashtrimeve financiare;
- Klienti blen sasi të mëdha të AV që nuk justifikohen nga pasuria apo në përputhje me profilin e tij financiar, që mund të jetë tregues i pastrimit të parave, rolit të “transportuesit” apo një viktimë mashtrimi.
- Një klient ndryshon shpesh informacionin e tij të identifikimit, adresat e postës elektronike, adresat IP ose informacionin financiar. Një sjellje e tillë, mund të jetë tregues i abuzimit të llogarisë së klientit nga persona të tjerë (pirat kibernetik).
- Një klient përpiket të hyjë në një ose më shumë OSHAV nga adresa të ndryshme IP
- Përdorimi i gjuhës në fushat e mesazheve AV, që tregojnë se transaksionet mund të lidhen me veprimtari të jashtëligjshme, shërbejnë për blerjen e mallrave të jashtëligjshme (p.sh. lëndë narkotike) ose përmbajnë informacione të vjedhura nga karta të kreditit.
- Një klient në mënyrë të përsëritur kryen transaksione me një grup individësh, të cilat rezultojnë me fitime ose humbje të konsiderueshme. Kjo sjellje, mund të jetë tregues i manipulimit të llogarisë (*account takeover*) dhe përvetësimit të fondeve të personave të mashtruar nëpërmjet tregëtisë, skemave të pastrimit të parave për të fshehur origjinën e fondeve nëpërmjet infrastrukturës së OSHAV.
- Transaksioni me adresa AV ose karta bankare që janë të lidhura me skema të njohur të mashtrimit, zhvatjes ose piraterisë kibernetike (ransomware), adresat e sanksionuara, tregjelt ilegale (darknet) apo faqe të tjera të jashtëligjshme.
- Transaksione AV me origjinë ose të destinuara për shërbime të lojërave të fatit në internet.
- Përdorimi i një ose shumë kartave të kreditit ose debitit që janë të lidhura me një portofol AV, për të tërhequr sasi të mëdha të monedhës legale, ose fonde për blerjen e AV që burojnë nga depozitat në para në kartat e kreditit.
- Depozitat në një llogari ose një adresë AV, janë dukshëm më të larta se të zakonshmet me një burim të panjohur fondesh, pasuar nga konvertimi në monedhën legale, gjë që mund të jetë tregues i vjedhjes së fondeve.
- Mungesë transparence ose informacioni i pamjaftueshëm për origjinën dhe pronarët e fondeve, të tilla si ato që përfshijnë përdorimin e kompanive guaskë ose fondet që investohen në një Ofertë Fillestare të Monedhave (ICO - Initial Coin Offering), për të cilat mungojnë të dhënat personale të investitorëve ose transaksione hyrëse nga sistemi i pagesave në internet përmes kartave të kreditit dhe ato të parapaguara, shoqërohen me tërheqje të menjëhershme.
- Fondet e klientit burojnë direkt nga shërbime kombinimi të ofruara nga palët e treta.
- Pjesa më e madhe e burimit të pasurisë së një klienti rrjedh nga investimet në AV, ICO ose ICO mashtruese.
- Burimi i pasurisë së një klienti, lidhet dukshëm më tërheqjen e AV nga OSHAV që kanë mangësi në zbatimin e PPP/FT.

- Fondet e klientit vijnë ose dërgohen në një platformë shkëmbimi, e cila nuk është e regjistruar në vëndin ku ndodhet klienti apo platforma.
- Klienti përdor një platformë shkëmbimi të AV ose shoqëri të transfertave në një vënd të huaj me rrezik të lartë dhe kontrole të mangëta në mbikqyrjen e AV për çështjet e PPP/FT, Vigjilencën e duhur dhe NjKT.
- Klienti dërgon fonde tek OSHAV që veprojnë në vënde që nuk zbatojnë në mënyrë adekuate masat e PPP/FT.
- Klienti krijon ose e zhvendos aktivitetin në vënde me nivel të ulët rregullimi ose mbikëqyrje të AV, pa pasur një arsye bindëse nga pikëpamja e biznesit.